

URDHËR
Nr. 314, datë 1.9.2015

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË MËSIMORE TË DISA INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PRIVAT

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 70 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë mësimore të institucioneve të arsimit parauniversitar privat, si më poshtë:

Nr	Emri i shkollës	Akti i licencimit	Njësia arsimore vendore
1	Shkolla “ToleAlba”	Urdhri nr. 297, datë 11.9.2009 “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor privat “Shkollë nëntëvjeçare””. Licenca e QKL-së, LC-5886-11-2010 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe sportiv”	Fier
2	Shkolla “Universh”	Urdhri nr. 34, datë 17.1.2008, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor parauniversitar “Shkolla e mesme e përgjithshme Universh””.	Fier
3	Shkolla “Dituria”	Urdhri nr. 299, datë 12.9.2009 “Për dhënien e lejes së funksionimit të shkollës 9-vjeçare “Dituria””. Licenca e QKL-së, LC-5031-04-2012 “Arsim i mesëm i përgjithshëm”	Fier
4	Shkolla “Vitrina”	1-Licenca e QKL, LC-3413-04-2010, gjimnaz me kohë të plotë “Vitrina” 2-Licenca e QKL nr. 3411-04-2010, shkollë e mesme elektronike “Vitrina” 3-Licenca QKL, nr. 3397-04-2010 Shkollë e mesme ekonomi-biznes “Vitrina”	Tiranë
5	Shkolla “Dyrrahu”	1-Urdhri nr. 260, datë 3.8.2009 “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar Gjimnazi “Dyrrahu”” 2- Urdhri nr. 259, datë 3.8.2009 “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar Shkolla nëntëvjeçare “Dyrrahu”	Durrës
6	Shkolla me kohë të pjesshme “Pavarësia”	Urdhri nr. 4265, datë 20.6.2014 “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor privat parauniversitar shkollës së mesme me kohë të pjesshme “Pavarësia”” Licenca e QKL-së, LC-5358-05-2014	Durrës

2. Institucionet arsimore të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, kanë këto detyrime:
- a) Të mbyllin të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë mësimore për vitin akademik 2014-2015, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - b) Të pajisin çdo nxënës me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar, brenda datës 10.9.2015.
 - c) Të vënë në dispozicion të njësisë arsimore vendore përkatëse, çdo informacion të kërkuar dhe të komunikojnë me to deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të përcaktuara në këtë urdhër.
 - d) Të kthejnë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur që mund të kenë ndaj nxënësit.
 - e) Të dorëzojnë në njësinë arsimore vendore përkatëse të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer.
 - f) Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të përballohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.
3. Njësitë arsimore vendore kanë për detyrë:
- a) Të ngrenë brenda datës 4.9.2015 një grup pune për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri nga institucionet e përcaktuara në pikën 1. Grupi i punës të menaxhojë transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar publik ose privat.
 - b) Të ruajnë në arkivin e tyre dhe në vijim të arkivojnë sipas ligjit për arkivat, të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucionet e përcaktuara në pikën 1.
4. Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për të gjithë personat juridikë, që përfaqësojnë institucionet e përcaktuara në pikën 1, të cilët nuk zbatojnë këtë urdhër.
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit, t’i kërkojë Qendrës Kombëtare të Licencimit kryerjen e veprimeve ligjore për çregjistrimin e subjekteve në fjalë.
6. Ngarkohen për zbatimin e urdhrit: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, njësitë arsimore vendore përkatëse dhe të gjitha subjektet juridike përfaqësuese të institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla